



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 570 Prot.

Tiranë, 29.01 2020

VENDIM

Nr. 3 datë 29.01 2020

***“Për ndryshim në Vendimin nr.52 datë 20.11.2019 të Senatit Akademik të UT “Për miratimin e periudhës zgjedhore dhe datës së zgjedhjeve për anëtar të Këshillave Studentorë të Fakulteteve të UT”***

Bazuar në nenin 38 dhe 99 të ligjit nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në nenin 31 dhe 133 të Statutit të UT; në nenin 5 të Rregulloren “Për zgjedhjet e para të këshillave studentorë në Universitetin e Tiranës”; pas Vendimit nr.750, datë 27.11.2019 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë” dhe pezullimit të procesit mësimor edhe në Universitetin e Tiranës deri në datën 6 dhjetor 2019, për të rifilluar në datën 10 dhjetor 2020; si dhe në Vendimin nr.211 datë 03.12.2019 të Rektorit të UT “Për pezullimin e periudhës zgjedhore për anëtarë të Këshillave Studentorë të Fakulteteve të UT”, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e tij të datës 29.01.2020,

VENDOSI:

Të miratojë ndryshimet e pikës 1 dhe 2 të Vendimit nr.52 datë 20.11.2019 të Senatit Akademik të UT, si më poshtë:

1. Të miratojë periudhën **20 prill 2020-20 maj 2020**, si periudhë zgjedhore për anëtarë të Këshillave Studentorë të Fakulteteve të Universitetit të Tiranës.
2. Të miratojë datën **20 maj 2020**, si datë të zgjedhjeve për anëtar të Këshillave Studentorë të Fakulteteve të Universitetit të Tiranës.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

